

VENDIM
Nr. 279, datë 4.5.2023

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 441, DATË 3.6.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT, MIRATUAR NË BUXHETIN E VITIT 2020, PËR FINANCIMIN E
HARTIMIT TË PROJEKTEVE PËR MIRATIMIN E LEJEVE TË NDËRTIMIT,
PËR NDËRTIMIN E NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), NË
ZONAT E SHPALLURA PËR ZHVILLIM TË DETYRUAR, NË BASHKITË
DURRËS, KAVAJË, KAMZË, MIRDITË, KRUJË, KURBIN, LEZHË, SHIJAK DHE
VORË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, të neneve 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 441, datë 3.6.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në titullin e vendimit hiqen fjalët “... miratuar në buxhetin e vitit 2020 ...”;

b) Pas pikës 2 shtohen pikat 2.1 dhe 2.2, me këtë përmbajtje:

“2.1 Përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2023, për financimin e hartimit të projektit për miratimin e lejeve të ndërtimit, përfshirë kostot për shërbime të rëlevimeve topografike, vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe të shërbimeve gjeologjike, që i takojnë nëntokës e punimeve në themel, për ndërtimin e njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në zonat e shpallura për zhvillim të detyruar, në bashkitë Durrës, Kamzë, Mirditë Kavajë, Krujë, Kurbin, Lezhë, Shijak dhe Vorë, në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë pa TVSH;

2.2 Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2023, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi”, i kalohet fondi në masën 5 000 000 (pesë milionë) lekë pa TVSH, për financimin e hartimit të projekteve, sipas përcaktimeve të pikës 2.1, të këtij vendimi.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku